



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 13

Tiranë – E mërkurë, 5 shkurt 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11425, datë 30.1.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 1047
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK nr. 2727, datë 4.2.2020	Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit..... 1047
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 1, datë 10.1.2020	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2019..... 1054
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 2, datë 10.1.2020	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2020 dhe shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për përcaktimin e tarifave, sipas nivelit të tensionit për vitin 2020..... 1056
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 4, datë 10.1.2020	Mbi mosfillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” nr. 263, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 8, datë 2.2.2015..... 1060
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 5, datë 10.1.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror..... 1061
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 6, datë 10.1.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror..... 1062
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 7, datë 16.1.2020	Mbi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020..... 1063

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 8, datë 16.1.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë”.....	1064
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 9, datë 16.1.2020	Mbi identifikimin dhe trajtimin si konfidencial të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “Wonder” sh.p.k., si pjesë e aplikimit për transferimin e kompetencave të menaxhimit dhe operimit të koncesionit HEC “Sasaj”.....	1066
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 20.1.2020	Mbi kërkesën për mos licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”.....	1068

**DEKRET****Nr. 11425, datë 30.1.2020****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ina Ilir Christmann (Malushi)
2. Anisa Adriatik Kapaj
3. Edlira Eqrem Ismaili (Kruja)
4. Dorina Qazim Dallaku (Meça)
5. Fjorinda Luan Shkurti (Kishta)
6. Vanesa Bekim Krasnici (Krasnići)
7. Zhelko (Željko) Pirro Matanović (Matanović)
8. Pranvera Bani Ciko
9. Armand Nazmi Rosgen (Jakupi)
10. Saimir Muharem Patogu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta

UDHËZIM**Nr. 2727, datë 4.2.2020**

**PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË
LIGJIT NR. 90/2019,
“PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË
PALUAJTSHME” DHE PËRCAKTIMIN E
TARIFËS SË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 4, të ligjit nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” dhe të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të

ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,

UDHËZOJNË:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR
RIVLERËSIMIN E PASURISË SË
PALUAJTSHME PËR INDIVIDËT**

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi, pasuri të paluajtshme (tokë dhe/ose ndërtesë) të regjistruar ose që fitojnë pronësinë dhe e regjistrojnë atë deri në datën 30 shtator 2020, kanë të drejtë që brenda këtij afati të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. Këtu përfshihen dhe rastet, kur për pasurinë e paluajtshme është bërë edhe më parë rivlerësimi.

2. Individit mund të zgjedhë vullnetarisht nëse rivlerësimin e pasurisë do ta bëjë ASHK-ja apo një ekspert i vlerësimit të pasurive, i licencuar nga institucionet përkatëse. Për të përfituar nga rivlerësimi, nëpërmjet pasqyrit të tij në regjistrin e pasurive të paluajtshme, individit duhet të paguajë më parë tatimin e rivlerësimit (3% e bazës së tatueshme) dhe tarifën e shërbimit, sipas ligjit nr. 90/2019.

3. Në rast se individit ka në pronësi më shumë se një pasuri të paluajtshme dhe do të bëjë rivlerësimin e secilës prej tyre, procedura e rivlerësimit është individuale për secilën prej këtyre pasurive.

**II. LLOGARITJA E BAZËS SË
TATUESHME PËR RIVLERËSIMIN E
PASURISË PËR INDIVIDËT**

4. Në rast se individit zgjedh që rivlerësimin e pasurisë ta bëjë ASHK-ja, ai bëhet me çmimet minimale fiskale, që janë në fuqi në momentin e kryerjes së procesit të rivlerësimit dhe në përputhje me përcaktimet e udhëzimit për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme. Në këtë rast, baza e tatueshme, llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi (sipas çmimeve minimale fiskale në fuqi) dhe vlerës së zbritshme.

5. Në rast se individit zgjedh rivlerësimin e pasurisë nga një ekspert i licencuar, baza e tatueshme, llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerës së zbritshme. Në çdo rast, vlera e pasqyruar në aktin e vlerësimit të pasurisë nga



eksperti i licencuar nuk mund të jetë më e vogël se çmimi minimal fiskal.

6. Vlera e zbritshme, si në rastin e pikës 4 dhe në atë të pikës 5, është vlera e pasurisë sipas së aktit të regjistruar (të fitimit të pronësisë) ose ajo sipas rivlerësimit të mëparshëm (për të cilin është paguar më parë tatimi).

Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë për të përcaktuar vlerën e zbritshme, drejtoria vendore e ASHK-së bazohet në vlerën e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit të aktit të fitimit të pronësisë.

6.1 Për zbatimin e këtij udhëzimi, brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i kërkon Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe Entit Kombëtar të Banesave listën e çmimeve të kostos mesatare të ndërtimit të banesave, në format digjital (*Excel*).

III. PARAQITJA DHE ADMINISTRIMI I KËRKESËS PËR RIVLERËSIM NGA INDIVIDËT

A. Aplikimi online

7. Individit ose përfaqësuesi i tij aplikon *online* për shërbimin e rivlerësimit të pasurisë, nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*. Në mënyrë që të pajiset me dokumentin zyrtar që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit, ai duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme ose të vërtetimit (për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

Aplikimi për shërbimet i drejtohet drejtorisë/zyrës vendore të ASHK-së që është kompetente për territorin ku gjendet pasuria e paluajtshme.

7.1 Individit që aplikon *online* për rivlerësimin e pasurisë duhet të plotësojë në rubrikat përkatëse të platformës *e-Albania*, të dhënat identifikuese të pasurisë që kërkohet të rivlerësohet. Nëse individit nuk plotëson rubrikat që identifikojnë pasurinë, ai duhet, detyrimisht, të ngarkojë në platformë kopje të skanuar të dokumentit të pronësisë që disponon për pasurinë.

7.2 Punonjësi i drejtorisë vendore të ASHK-së shqyrton aplikimin, duke verifikuar:

a) identifikimin e pasurisë sipas përcaktimeve të pikës 7.1; dhe

b) legjitimitimin e individit aplikues. Punonjësi verifikon nëse individit që ka paraqitur kërkesën

për rivlerësim (ose i përfaqësuari) është pronar apo një nga bashkëpronarët e pasurisë që kërkohet të rivlerësohet.

Nëse nuk përmbushen kushtet e mësipërme, individit njoftohet nëpërmjet platformës, për të identifikuar pasurinë ose për mosvijimin e aplikimit (në rast moslegjitimitimi).

7.3 Nëse aplikimi i përmbush kushtet e pikës 7.2, vijohet me llogaritjen e tatimit të rivlerësimit, sipas rregullave të kreut II të këtij udhëzimi, duke hartuar faturën për arkëtim.

7.4 Fatura për arkëtim plotësohet sipas modelit të shtojcës nr. 3 bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Fatura nënshkruhet dhe vulolet elektronikisht nga drejtoria vendore e ASHK-së dhe së bashku me tarifat e shërbimit, i dërgohet aplikuesit nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

7.5 Përjashtimisht, kur individit kërkon rivlerësimin sipas aktit të ekspertit të licencuar, dërgimi nëpërmjet platformës, i faturës së tatimit të nënshkruar dhe të vulosur elektronikisht, së bashku me tarifën e shërbimit, kryhet vetëm pasi të jetë administruar fizikisht (me postë) akti origjinal i vlerësimit të pasurisë, i nënshkruar dhe i vulosur nga eksperti vlerësues i pasurisë, si dhe fotokopje e njësuar e licencës së tij. Për këtë, individit krahas aplikimit *online*, duhet të dërgojë me postë në zyrën/në drejtorinë vendore të ASHK-së dokumentacionin fizik të mësipërm.

7.6 Pasi të jetë verifikuar shlyerja e pagesës së tatimit të rivlerësimit dhe të tarifave të shërbimit, aplikimi i individit konsiderohet i plotësuar dhe ASHK-së i lind detyrimi për të pasqyruar rivlerësimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të këtij udhëzimi.

B. Aplikimi në sportel

8. Përjashtimisht, në rastet kur është e pamundur të administrohet aplikimi nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, aplikimi kryhet pranë zyrës pritëse (sportelit) në drejtorinë/zyrën vendore kompetente, duke paraqitur “Kërkesën për rivlerësim”, sipas formularit (shtojca nr. 1) që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Në mënyrë që të pajiset me dokumentin zyrtar që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit, individit duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së



paluajtshme, ose të vërtetimit (për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

9. Individit apo përfaqësuesit i tij, me prokurë, në çdo rast paraqitet me dokument identifikimi pranë zyrës pritëse ASHK-së. Ai pajiset me dy kopje të paplotësuara të formularit “Kërkesë për rivlerësim” nga punonjësi përgjegjës.

9.1 Individit apo përfaqësuesit i tij, me prokurë, plotëson 2 pikat e para të formularit. Të dhënat e plotësuara në formular dhe dokumentacionin bashkëlidhur (kopje të dokumentit të pronësisë) verifikohen sipas përcaktimeve të pikës 7.2 të këtij udhëzimi.

9.2 Në rast përputhjeje të të dhënave, punonjësi përgjegjës plotëson pikën 3 të formularit me vlerën e zbritshme (vlera e pasurisë, sipas aktit të regjistrimit, ose vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar më parë tatimi).

9.3 Punonjësi llogarit tatimin që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi, sipas kreut II të këtij udhëzimi, duke plotësuar pikën 4 të formularit “Kërkesë për rivlerësim”.

9.4 Pas plotësimit të të gjithë pikave të mësipërme të formularit “Kërkesë për rivlerësim”, punonjësi përgjegjës e nënshkruan atë dhe një kopje ia jep individit ose përfaqësuesit të tij. Individit ose përfaqësuesit i tij pajiset, gjithashtu, me faturën për arkëtim (shtojca nr. 3) për pagesën e tatimit, si dhe për tarifën e shërbimit.

9.5 Individit, pasi paguan në bankë tatimin dhe tarifën e shërbimit, dorëzon vërtetimin e pagesës së tyre pranë drejtorisë vendore të ASHK-së. Vërtetimi i pagesës i bashkëlidhet formularit të aplikimit.

9.6 Pas kryerjes së pagesës së tatimit dhe tarifave të shërbimit, aplikimi konsiderohet i plotësuar dhe drejtorisë vendore i lind detyrimi për të pasqyruar rivlerësimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të këtij udhëzimi.

IV. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PASQYRIMIN E RIVLERËSIMIT TË PASURISË NË REGJISTRAT E PASURIVE TË PALUAJTSHME

10. Në zbatim të ligjit nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, drejtoria vendore e ASHK-së, brenda 5 ditëve nga verifikimi i pagesës së tatimit të rivlerësimit të

pasurisë dhe tarifave të shërbimit, duhet të kryejë shënimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për pasqyrimin e rivlerësimit, nëpërmjet punonjësit të ngarkuar me këtë detyrë. Data e rivlerësimit të pasurisë është data e pagimit të tatimit të rivlerësimit.

11. Punonjësi i ASHK-së kryen shënimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, bazuar në dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas rasteve të parashikuara me poshtë:

11.1 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, pasqyrimi i rivlerësimit të pasurisë kryhet në seksionin “D” të kartelës së pasurisë.

Në këtë seksion do të regjistrohet data e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shuma e rivlerësimit, referenca arkivore përkatëse, si dhe afati i vlefshmërisë së këtij regjistrimi. Për afatin e vlefshmërisë vendoset shënimi: “Ky regjistrim është i vlefshëm deri në kryerjen e një transaksioni mbi pasurinë e rivlerësuar, përveç trashëgimisë, në përputhje me udhëzimin nr. 29, datë 30.7.2018”.

Me kryerjen e një transaksioni të ri për tjetërsimin e pasurisë (përveç trashëgimisë), pasuria merr vlerën sipas aktit të ri të kalimit të pronësisë.

11.2 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, nuk i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, pasqyrimi i rivlerësimit kryhet në rubrikën/kolonën “Shënime transkriptimi” të regjistratit hipotekar, duke përcaktuar datën e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shumën e rivlerësimit, referencën arkivore përkatëse, si dhe afatin e vlefshmërisë së këtij regjistrimi. Për afatin e vlefshmërisë vendoset shënimi: “Ky regjistrim është i vlefshëm deri në kryerjen e një transaksioni mbi pasurinë e rivlerësuar, përveç trashëgimisë, në përputhje me udhëzimin nr. 29, datë 30.07.2018”.

Me kryerjen e një transaksioni të ri për tjetërsimin e pasurisë (përveç trashëgimisë), pasuria merr vlerën sipas aktit të ri të kalimit të pronësisë.

11.3 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, gjendet në një zonë kadastrale që është duke iu nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, procedohet me regjistrimin e këtij të



fundit në regjistrin përkatës hipotekar apo në kartelat provizore, duke pasqyruar datën e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shumën përkatëse të rivlerësimit, referencën arkivore, si dhe shënimin për afatin e vlefshmërisë së regjistrimit të rivlerësimit, njësoj si në dispozitat e mësipërme (11.1 dhe 11.2).

Në përfundim të procesit të regjistrimit fillestar, shënimet e mësipërme të rivlerësimit pasqyrohen në kartelat e pasurive të paluajtshme, produkt i këtij procesi.

V. RIVLERËSIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME TË PERSONAVE JURIDIKË

12. Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2019, në zërin aktive afatgjata materiale, pasuri të paluajtshme me vlerë kontabël më të vogël se vlera e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin e këtyre pasurive të paluajtshme me vlerën e tregut. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga vlerësues të pasurisë, ekspertë të pavarur të licencuar nga institucionet përkatëse për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

13. Përfaqësuesi i personit juridik paraqet pranë drejtorisë rajonale tatimore, ku personi juridik është i regjistruar, dokumentet e mëposhtme:

a) deklarin vullnetar për rivlerësimin e pasurisë, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) prokurën për përfaqësuesin ligjor, nëse kjo procedurë kryhet nga një përfaqësues ligjor i caktuar prej tij;

c) kopje të licencës së ekspertit të pavarur të vlerësimit të pasurisë;

d) kopje të faturës së shërbimit të ekspertit të vlerësimit të pasurisë;

e) aktin origjinal të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruar dhe të vulosur nga vlerësuesi i pasurisë;

f) pasqyrën financiare (bilancin kontabël) të vitit 2019, ku rezulton e regjistruar në zërin aktive afatgjata materiale, pasuria e paluajtshme që rivlerësohet, përfshirë anekset shpjeguese për aktivin afatgjatë material që rivlerësohet;

g) kopjen e mandatit të pagesës për vlerësimin e pasurisë, në masën 5% të diferencës, ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël për

pasuritë e paluajtshme të regjistruara në pasqyrat financiare. Pagesa kryhet në njërën nga bankat e nivelit të dytë për llogari të thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën nr. 4.

Personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme, ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivitetit dhe tatimit përkatës, të paguar sipas legjislacionit në fuqi.

13.1 Data e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme konsiderohet data e pagesës së kryer, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 3, të ligjit nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

13.2 Diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit përkatës të ekspertit dhe vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare, regjistrohet përkatësisht në zërin përkatës të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Kjo vlerë nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore.

13.3 Pasqyrave financiare për rivlerësimet që kryhen brenda periudhës gjatë së cilës i shtrihet efektet ligji, sipas nenit 5 të tij, u bashkëlidhen pasqyrat analitike të vlerës kontabël të pasurive të paluajtshme të rivlerësuar.

VI. PAGESA E TË ARDHURAVE NGA TATIMI I RIVLERËSIMIT NË BUXHETIN E SHTETIT

14. Pagesa e tatimit nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme kryhet pranë bankave të nivelit të dytë, sipas modeleve të formularit të faturës për arkëtim, përkatësisht, për individët (shtojca nr. 3) ose për personat juridikë (shtojca nr. 4), që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

15. Klientëve-individë u vihet në dispozicion formulari i faturës nga drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së.

16. Klientëve-persona juridikë, u vendoset në dispozicion formulari nga degët përkatëse të bankave. Gjithashtu, ky formular mund të shkarkohet edhe elektronikisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.



17. Për personin juridik është e detyrueshme që, përveç të dhënave të nënshkruesit, në faturën për arkëtim të plotësohen, gjithashtu, emri i personit juridik (shoqërisë) dhe NIPT/NUIS. Pas verifikimit për plotësimin e të dhënave të plota, banka në zbatim të marrëveshjes dypalëshe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pranon të kryejë arkëtimin, duke evidentuar llojin e të ardhurës, si dhe kodin e institucionit sikurse është përcaktuar në “Faturën për arkëtim”, në bazë të kodit të të cilave do të kryhet kontabilizimi në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ).

18. Tatimi mbi të ardhurat nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme (3%), që paguhet nga individë, arkëtohet në një llogari të veçantë të hapur nga çdo drejtori vendore e ASHK-së pranë bankave të nivelit të dytë. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, vlera e tatimit kalohet në llogarinë e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në buxhetin e shtetit, në drejtoritë tatimore përkatëse.

Brenda së njëjtës datë (të çdo muaji pasardhës), drejtoritë vendore të ASHK-së dërgojnë në drejtoritë tatimore përkatëse evidencën manuale dhe/ose elektronike, me të dhënat e individit që ka kryer rivlerësimin e pasurisë, si dhe shumën e tatimit të llogaritur nga rivlerësimi.

19. Llogaritja dhe arkëtimi i tatimit 5% për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të personave juridikë bëhet nga drejtoritë rajonale tatimore përkatëse. Ky tatim llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të pasurisë të regjistruar në pasqyrat financiare të vitit 2019. Kontabilizimi i tatimit nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%) do të bëhet në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7020400, për llogari të buxhetit të shtetit.

Banka transferon arkëtimet në llogaritë bankare përkatëse në emër të degës së thesarit të çdo rrethi për çdo drejtori rajonale tatimore, sipas kodeve përkatëse të çdo drejtorie.

Drejtoritë rajonale tatimore, çdo muaj, bëjnë rakordimin me degën e thesarit për arkëtimet e kryera, në përputhje me këtë udhëzim.

20. Në raste të derdhjeve gabim të tatimit të rivlerësimit për individët dhe detyrimit për të

kthyer tërësisht ose pjesërisht shumën, drejtoritë vendore të ASHK-së hartojnë dokumentacionin justifikues për kthimin e shumës tek individë, pas kërkesës së individit.

Në rast se individë paraqet kërkesën për kthim shume, brenda datës 10 të muajit pasardhës, drejtoria vendore e ASHK-së bën drejtpërdrejt kthimin e shumës të arkëtuar gabim. Nëse është tejkaluar ky afat dhe të ardhurat kanë kaluar në buxhetin e shtetit, kërkesën, individë duhet ta paraqesë për kthimin e shumës së mbajtur gabim pranë drejtorisë tatimore përkatëse. Në funksion të kthimit të shumës së mbajtur gabim, drejtoria vendore e ASHK-së dërgon dokumentacionin justifikues provues pranë drejtorisë tatimore përkatëse, e cila pas administrimit të dokumentacionit kthen shumën e mbajtur gabim tek individë.

VII. TARIFA E SHËRBIMIT DHE DISPOZITA TË FUNDIT

21. Tarifa për shërbimin e rivlerësimit për individët, pranë ASHK-së, është 1200 (një mijë e dyqind) lekë.

22. Pas kryerjes së rivlerësimit për individët, sipas këtij udhëzimi, në rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të rivlerësuar, në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar, si diferencë e vlerës në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vlerën e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi. Nëse kjo diferencë është negative, individë nuk paguan tatim.

23. Aplikimet për rivlerësim të pasurive të cilat paraqiten pranë ASHK-së, brenda 30 shtatorit 2020, por nuk janë përfunduar, procedohen edhe pas kësaj date, nëse tatimi i rivlerësimit është paguar brenda datës së mësipërme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË
DHE FINANCIVE
Anila Denaj**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I ASHK-së
Artan Lame**



SHTOJCA NR. 1
FORMULAR “KËRKESË PËR RIVLERËSIM” (PËR INDIVIDËT)

Drejtuar: drejtorisë/zyrës vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

1. Të dhënat e aplikuesit

Emri/atësia/mbiemri i aplikuesit: _____

Numri i identifikimit në kartën e identitetit _____, lëshuar nga _____

Data e lëshimit: _____

Adresa e banimit _____, adresa e dytë(nëse ka) _____

2. Të dhënat e pasurisë së paluajtshme

Në përputhje me ligjin nr. 90/, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, aplikoj për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

Lloji i pasurisë së paluajtshme (tokë/ndërtesë)

Numri i regjistrimit në zyrën kadastrale _____, sipërfaqja në m² (me shifra dhe me fjalë) m² _____

Data e regjistrimit në ASHK: _____

Çmimi i blerjes së pasurisë, bazuar në kontratën e shitblerjes/vlera e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi _____

(me shifra dhe me fjale për t’u plotësuar nga ASHK-ja)

3. Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme

3.1 Në rast se kryhet nga ASHK-ja

Vlera e pasurisë në vitin 2020, sipas çmimeve minimale fiskale në fuqi

(në shifra dhe me fjalë)

3.2 Në rast se kryhet nga eksperti i pasurisë

Vlera e pasurisë në vitin 2020, sipas aktit të ekspertimit

(me shifra dhe me fjalë)

4. Tatimi për t’u paguar

4.1 Baza e tatueshme = (vlera e dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi minus vlerën e pasurisë së aktit të regjistruar apo vlerën e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi)

Tatimi = (3% e bazës së tatueshme)

4.2 Baza e tatueshme = (vlera e tregut të pasurisë së pasqyruar në akt ekspertimi (jo më e vogël se çmimi minimal fiskal) minus vlerën e pasurisë, sipas aktit të regjistruar apo të vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi)

Tatimi = (3% e bazës së tatueshme)

Data dhe nënshkrimi i aplikuesit: _____

Aplikimi është marrë nga personi i autorizuar nga ASHK-ja:



SHTOJCA NR. 2

DEKLARIMI VULLNETAR PËR RIVLERËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË PERSONAVE JURIDIKË

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale të Tatimeve: _____

Deklarim vullnetar për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme

Unë z./znj. _____, përfaqësuesi i personit juridik _____, me NIPT/NUIS _____, me adresë _____, pajisur me autorizim për përfaqësim _____, deklaroj se në bazë të ligjit nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, deklaroj vullnetin tim për të kryer rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme të regjistruar në pasqyrën financiare (bilanci kontabël) të periudhës _____.

Baza e tatueshme = (diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit të ekspertit dhe të vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare (në shifra dhe fjalë)

Pagesa = 5% x bazën e tatueshme _____

Emri/mbiemri: _____
(nënshkrimi)

Data: _____

SHTOJCA NR. 3

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. _____, datë _____

Bankës _____

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka juaj të pranojë nga klientë (individë) arkëtime të të ardhurave, për llogari të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme, me emërtimet, kodin dhe shumat përkatëse, si më poshtë:

Kodi i llogarisë ekonomike ku do të derdhet tatimi nga rivlerësimi është _____

Emri institucionit: Drejtoria Vendore e ASHK-së _____

Numri i llogarisë dhe IBAN për RVP: _____

Kodi i degës së thesarit: _____

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave/emërtimi	Mënyra e përlllogaritjes	Shuma që arkëtohet (lekë)	Nr. i llogarisë së DVASHK-së për RVP-në
1	Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) të bërë nga ASHK-ja	3% (e vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale – (minus) vlerën e pasurisë së aktit të regjistruar/të rivlerësuar)		
2	Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) të bërë nga eksperti vlerësues i licencuar	3% (e vlerës së dalë nga akti i ekspertimit, jo më pak se çmimet minimale fiskale – (minus) vlerën e pasurisë sipas aktit të regjistruar, /të rivlerësuar)		

DREJTORIA VENDORE ASHK
Emër/mbiemër/firmë _____

KLIENTI
Individ _____
Emër/mbiemër _____



SHTOJCA NR. 4
FATURË PËR ARKËTIM

Nr. _____, datë _____

Bankës _____

Me anë të kësaj fature kërkohet që banka juaj të pranojë nga klientë (persona juridike/individë) arkëtime të të ardhurave, për llogari të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme, me emërtimet, kodin dhe shumat përkatëse, si më poshtë:

Kodi i llogarisë ekonomike ku do të derdhet tatimi nga rivlerësimi është _____

Emri institucionit përfitues (teknik): Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme

Kodi i institucionit përfitues: Sipas kodeve përkatëse të çdo rrethi _____

Kodi i degës së thesarit: Sipas kodeve përkatëse të çdo rrethi _____

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave/emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	Shuma që arkëtohet (lekë)
1	... tatim nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%)		

DREJTORIA TATIMORE

Emër/mbiemër/firmë

KLIENTI

Person juridik _____

NIPT/NUIS: _____

Administratori/përfaqësuesi _____

Emër/mbiemër/nënshkrimi _____

Adresa: _____

Kontakti: _____

VENDIM

Nr. 1, datë 10.1.2020

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN DHJETOR 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 314

prot., datë 9.1.2020, përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin dhjetor 2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 25963 prot., datë 27.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 109/21 prot., datë 30.12.2019, paraqiti aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 , të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2019.

- Gjatë analizës së informacionit të paraqitur në këtë aplikim u evidentuan disa paqartësi dhe mangësi, në lidhje me llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike dhe kursin e këmbimit të cilin shoqëria ka përdorur, këto konstatime iu bënë me dije OSHEE sh.a. nëpërmjet komunikimit në adresën zyrtare elektornike të shoqërisë.



- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 75 prot., datë 8.1.2020, paraqiti aplikimin e saktësuar në të cilin ka llogaritur çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e FMF-së për muajin dhjetor 2019, në vlerën 16.57 lekë/kwh.

- Llogaritjet e OSHEE sh.a., si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që

furnizohen nga FMF-ja, për muajin dhjetor, sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

ÇMIMI I FMN-SË PËR MUAJIN DHJETOR 2019

Dhjetor 2019		Aplikimi i OSHEE sh.a.	Propozimi i ERE-s
	Njësia	Çmimi	Çmimi
a) Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	lekë/kwh	12.161	12.161
b) Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	lekë/kwh	0.36	0.36
c) Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante	lekë/kwh	12.53	12.53
d) Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	lekë/kwh	1.79	1.79
e) Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	lekë/kwh	0.75	0.75
f) Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	lekë/kwh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë (c+d+e+f)	lekë/kwh	16.57	16.57

- Duke u bazuar në informacionin e aplikimit të muajit dhjetor, që shoqëria OSHEE sh.a. ka paraqitur në ERE, raportimeve periodike mujore për blerjen e energjisë elektrike në tregun e parregulluar, si dhe nga kontrolli i platformës *online*, ku shoqëria publikon informacionin e detajuar mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, rezulton se për këtë muaj nuk është zhvilluar asnjë procedurë për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar. Në vijim, shoqëria shprehet se në zbatim të metodologjisë për çmimin maksimal të blerjes së energjisë për këtë muaj i është referuar çmimit të energjisë nga prodhuesit me përparësi i cili është 0.1 €/kwh.

- Shoqëria OSHEE sh.a. deklaron se për llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike ka përdorur kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 26.12.2019, kjo për arsye të afateve kohore të mbylljes së ciklit të faturimit për muajin dhjetor 2019 për klientët FMF, meqenëse gjatë këtij muaji nuk ka pasur blerje energjie në treg të parregulluar për këta klientë.

- Duke iu referuar kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë prej 121.61 lekësh/eurosh, që shoqëria ka konsideruar në këtë aplikim, çmimi i

blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar rezulton të jetë 12,161 lekë/kwh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 266, datë 21.12.2018, “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a. për vitin 2019” është 0.75 lekë/kwh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.8.2018, në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 lekë/kwh.

- Për sa përcaktohet për çdo element të formulës përlllogaritëse rezulton që çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2019, të jetë 16.57 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 16.57 lekësh/kwh, për muajin dhjetor 2019.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 2, datë 10.1.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
FSHU SHA PËR PËRCAKTIMIN E
ÇMIMIT TË SHITJES ME PAKICË PËR
KLIENTËT QË SHËRBEHEN NGA
FURNIZUESI I SHËRBIMIT
UNIVERSAL PËR VITIN 2020 DHE
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFAVE, SIPAS NIVELIT TË
TENSIONIT PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 19, të nenit 20, germa “c”, të nenit 21 dhe të nenit 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017, “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të

Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017; të nenit 15, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionet e Drejtorisë së Tarifave dhe të Çmimeve nr. 3/5 prot., datë 10.1.2020, në lidhje me shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a., për çmimin e shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2020 dhe nr. 3/5 prot., datë 9.1.2020, në lidhje me shqyrtimin e aplikimit të OSSH sh.a., për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2020,

konstatoi:

- Në lidhje me aplikimin e FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020:

- Bazuar në nenin 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE është institucioni përgjegjës për miratimin e tarifave për veprimtaritë e licencuara për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik.

- Me shkresën nr. prot. 3, datë 6.1.2020, FSHU sh.a. ka paraqitur aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike me pakicë për vitin 2020, për klientët që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU sh.a.).

- Në aplikim sqarohet se FSHU sh.a. fillon operimin si një shoqëri e pavarur prej datës 1.1.2020, bazuar në detyrimet e përshkruara në licencën e furnizimit dhe atë të Shërbimit Universal, për të cilat ERE, me vendimet nr. 98, datë 17.6.2016 dhe nr. 112, datë 8.7.2016, vendosi miratimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike dhe përcaktoi FSHU-në për detyrimin e shërbimit universal, në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe VKM-në nr. 244, datë 30.3.2015, të ndryshuar.

- Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u furnizuar klientëve të cilët shërbehen nga Furnizuesi Universal për vitin 2020 parashikohet të jetë 5,090 gwh. Përlllogaritja e kërkesës për energji është bazuar në strukturën aktuale dhe parashikimin për vitin në vazhdim, por që në varësi të ndryshimeve të kërkesës së klientëve tariforë



mund të jetë, gjithashtu, objekt i kompensimeve për diferenca në periudha të tjera.

- Energjia elektrike e parashikuar, për furnizimin e klientëve tariforë që shërbehen nga FSHU-ja, do të mbulohet nga energjia elektrike e prodhuar nga shoqëria KESH sh.a. dhe diferenca e mbetur do të plotësohet nga sasia e energjisë elektrike të mbetur nga prodhimi i HEC-ve private pas plotësimit të sasisë së humbjeve në rrjet nga OSSH-ja dhe sasia e energjisë elektrike të blerë në tregun e lirë.

- Shoqëria deklaron se çmimet për vitin 2020, me të cilat KESH-i, HEC-et private dhe OST-ja i shesin energji elektrike dhe shërbimin e transmetimit shoqërisë FSHU-së janë supozuar në 1.5 lekë/kwh për energjinë e blerë nga KESH, 8.46 lekë/kwh nga HEC-et private dhe 0.75 lekë/kwh për shërbimin e transmetimit nga OST-ja. Sipas shoqërisë, çmimi i energjisë elektrike të parashikuar për t'u blerë në tregun e lirë, gjatë vitit 2020, është përllëgaritur bazuar në monitorimin e tregut të lirë për vitin 2019 dhe mund të ndryshojë duke u llogaritur si kompensim në vitet e ardhshme të përllëgaritjes së çmimit të shitjes së energjisë me pakicë të energjisë elektrike.

- Për vitin 2019, shoqëria deklaron se kostoja mesatare e energjisë elektrike të blerë për klientët që shërbehen nga FSHU-ja rezulton të jetë afërsisht 5 lekë/kwh, nga ajo prej 4.13 lekësh/kwh e planifikuar, me një efekt prej rreth 5.6 miliardë lekësh më shumë, si rrjedhojë e mosrealizimit të furnizimit të parashikuar nga KESH, për shkak të situatës jo të favorshme hidrologjike.

- Shoqëria ka paraqitur në formë sintetike shpenzimet operative të parashikuara për vitin 2020 të llogaritura sipas koeficientëve, bazuar në një studim mbi ndarjen e shoqërisë OSHEE në shoqëritë OSSH dhe FSHU, duke u mbështetur në të dhënat historike dhe realizimin e tyre për periudhën 2016–2019, buxhetimin e shpenzimeve operative për vitin 2020, si dhe realizimin e të ardhurave të kërkuara për vitet 2015–2019 dhe ato të parashikuara për vitin 2020.

- Shoqëria deklaron se amortizimi i aseteve për vitin 2020 është llogaritur në nivelin 10% mbi amortizimin e aseteve shtesë për vitin 2019.

- Shoqëria duhet të paraqesë llogaritjet e amortizimit të akumuluar për periudhën 2015–2019, për asetet dhe shtesat sipas viteve të cilat i përkasin shoqërisë FSHU sh.a., krahas aseteve fikse të cilat do të transferohen nga shoqëria “mëmë”

dhe do t'i shërbejnë shoqërisë FSHU sh.a. për ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

- Shoqëria deklaron se marzhi i fitimit i llogaritur nga FSHU-ja rezulton në nivelin 3%, i cili është llogaritur mbi kostot për blerjen e energjisë. Theksojmë, që sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, përcaktohet se marzhi i fitimit do të jetë një përqindje fikse, e cila nuk do të jetë më shumë se 3% mbi koston e blerjes së energjisë.

- Kostoja e lejuar e kapitalit të punës është llogaritur në vlerën 222 milionë lekë, bazuar në përcaktimet e metodologjisë së lartpërmendur.

- Kompensimi për borxhin e keq është llogaritur në masën 5%, bazuar në përcaktimet e VKM-në nr. 253, datë 24.4.2019, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjetik”.

- Shoqëria FSHU sh.a. duhet të paraqesë analizat mbi llogaritjet e saj për shpenzimet operative, shpenzimet e amortizimit dhe marzhin e fitimit për secilën kategori të klientëve, duke përfshirë klientët të cilët janë të lidhur në TM, por me matje në TU dhe klientët e kategorizuar si objekte kulti, bazuar në përqindjet e sasive të energjisë elektrike të parashikuara për vitin 2020 për çdo kategori, sipas përcaktimeve të nenit 7, të “Metodologjisë së Përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”.

- Shoqëria ka paraqitur të ardhurat e kërkuara dhe të gjithë komponentët e saj për periudhën 2015–2020.

- Shoqëria ka marrë parasysh zhvillimet pozitive të ekonomisë shqiptare në mosllogaritjen e ndonjë faktori jopozitiv në provigjionime të mundshme për efekt të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë.

- Për sa u përket të dhënave të paqarta apo saktësimeve të nevojshme në këtë aplikim, do t'i kërkohej shoqërisë informacion dhe plotësimi i aplikimit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

- Në përfundim, shoqëria ka paraqitur totalin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2020, në vlerën 57.054 miliardë lekë, për sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u shitur te klientët që



shërbehen nga FSHU-ja prej 5,090 gwh, duke rezultuar në një tarifë mesatare të shitjes së energjisë elektrike 11.21 lekë/kwh për vitin 2020 dhe duke propozuar që çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike, si dhe çmimet e detajuara sipas vendimit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014 të mos ndryshojnë.

- Në lidhje me aplikimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020:

- Bazuar në nenin 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE është institucioni përgjegjës për miratimin dhe publikimin, në përputhje me parimin e transparencës dhe duke marrë në konsideratë koston e shërbimit të ofruar e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 25971 prot., datë 30.12.2019, protokolluar me tonën me nr. 4 prot., datë 6.1.2020, shoqëria OSHEE sh.a., në rolin e shoqërisë mëmë, ka paraqitur aplikimin për tarifat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2020.

- Në aplikim sqarohet, se OSSH sh.a. fillon operimin si një shoqëri e pavarur prej datës 1.1.2020.

- Nga analiza e aplikimit vërehet se plotëson, kryesisht, kërkesat e parashikuara në “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE- s nr. 96, datë 17.6.2016.

- Shoqëria deklaron, se në përlogaritjen e tarifës ka marrë parasysh gjendjen e vështirë financiare që po kalon shoqëria, për shkak të rritjes së shpenzimeve për sigurimin e energjisë elektrike nga tregu i lirë, si rrjedhojë e mosrealizimit të furnizimit nga KESH, për shkak të situatës jo të favorshme hidrologjike. Theksojmë se ky deklaram i shoqërisë i përket aktivitetit të shoqërisë FSHU sh.a., e cila siguron nga KESH sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik.

- Shoqëria deklaron se kërkesa për energji elektrike për vitin 2020 parashikohet të jetë në sasinë prej 5,196 gwh, e cila përbëhet nga sasia prej 5091 gwh e parashikuar për t'u shpërndarë FSHU sh.a. dhe sasia prej 105 gwh, e cila do t'u shpërndahet klientëve të tjerë në treg të liberalizuar.

- Shoqëria OSSH ka paraqitur në formë sintetike shpenzimet operative të parashikuara për vitin 2020, të cilat janë përlogaritur bazuar në një studim mbi ndarjen e shoqërisë OSHEE në shoqëritë OSSH dhe FSHU, si dhe duke u mbështetur në të dhënat historike për realizimin e tyre për periudhën 2016–2019 dhe buxhetimin e shpenzimeve operative për vitin 2020.

- Shoqëria deklaron se përlogaritja e kërkesës për energji për mbulimin e humbjeve është bazuar në parashikimin për vitin në vazhdim, por që në varësi të ndryshimeve në treg mund të jetë, gjithashtu, objekt i kompensimeve për diferenca në periudha të tjera. Sasia e energjisë elektrike të injektuar në sistemin e shpërndarjes për vitin 2020 parashikohet të jete 6,495 gwh, ku sasia e energjisë elektrike të shpërndarë parashikohet të jetë 5,196 gwh, kurse humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes janë vlerësuar nga shoqëria në sasinë 1,299 gwh, duke parashikuar që niveli i humbjeve të sasi e cila përbën 20%.

- Shoqëria sqaron se energjia elektrike për humbjet në rrjet mbulohet nga prodhimi i HEC-eve private dhe nga prodhuesit nga burime të rinovueshme, ndërsa në rastet kur sasia e prodhuar nga ato është më e vogël se sasia e humbjeve në rrjet, diferenca do të blihet në tregun e lirë.

- Çmimet me të cilat HEC-et private, prodhuesit nga burime të rinovueshme dhe OST do t'i shesin shoqërisë OSSH sh.a. energjinë elektrike dhe shërbimin e transmetimit, janë supozuar 8.46 lekë/kwh për energjinë e blerë nga HEC-et private, 12.46 lekë/kwh për energjinë e blerë nga burime të rinovueshme dhe në 0.75 lekë/kwh për shërbimin e transmetimit nga OST-ja.

Lidhur me sa më sipër, theksojmë se shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, të llogaritura me çmimin mesatar të ponderuar prej 8.5 lekë/kwh, duhet të rishikohen në funksion të çmimeve të miratuara nga ERE për prodhuesit ekzistues me përparësi dhe prodhuesit e rinj të energjisë elektrike për vitin 2020.

- Shoqëria ka pasqyruar bazën e rregulluar të aseteve (RAB), duke evidentuar vlerën bruto të tyre, si dhe amortizimin total të akumuluar për periudhën 2015–2019.

- Shoqëria duhet të paraqesë bazën e rregulluar të aseteve (RAB), duke evidentuar shtesat e aseteve



të kapitalizuara në formë analitike, të cilat i përkasin shoqërisë OSSH sh.a., llogaritjet e amortizimit të akumuluar për periudhën 2015–2019, si dhe parashikimet për vitin 2020.

- Shoqëria ka propozuar që kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC) të jetë 8.03%, sipas arsyetimeve të paraqitura në aplikim.

- Shoqëria ka marrë parasysh zhvillimet pozitive të ekonomisë shqiptare në mosllogaritjen e ndonjë faktori jopozitiv në provigjionime të mundshme, për efekt të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë.

- Në përlllogaritjen e të ardhurave të kërkuara, shoqëria kërkon vlerën prej 12.4 miliardë lekë si të ardhur të paralelizuar nga aplikimi i tarifave aktuale, për periudhën 2015–2019, dhe propozon që për kompensimin e kësaj humbjeje financiare, të shkaktuar kryesisht nga aktiviteti i shërbimit të shpërndarjes, të aplikohet si korigjim në tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike, vlera prej 3 miliardë lekësh/vit për 4 vjetët e ardhshëm.

- Shoqëria deklaron se në kushtet e mungesës së informacionit të detajuar për të llogaritur saktësisht, tarifën për nivel tensioni, sikurse është përmendur edhe në aplikim, për përlllogaritjen e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020, është bazuar në:

- kërkesën për të ardhura të vitit 2020 të llogaritur për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes;

- koeficientët e shpërndarjes së shpenzimeve (alokimit) që marrin parasysh sasinë e energjisë së shitur, sipas strukturës së shitjes, strukturën e aseteve sipas nivelit të tensionit dhe humbjet teknike të energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit.

- Për sa u përket të dhënave të paqarta apo saktësimeve të nevojshme në këtë aplikim, do t'i kërkohej shoqërisë informacion shtesë dhe plotësimi i aplikimit përgjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

- Në përfundim, shoqëria ka paraqitur totalin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2020 në vlerën 30.994 miliardë lekë, për sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u livruar në rrjetin e shpërndarjes prej 5,196 gwh, duke rezultuar në një tarifë mesatare shpërndarjeje prej 5.97 lekësh/kwh nga tarifa prej 4.79 lekësh/kwh në fuqi, me propozimin për miratimin e tarifave, sipas nivelit të tensionit për vitin 2020, si më poshtë vijon:

a) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 35 kV–3.32 lekë/kwh nga tarifa prej 1.5 lekësh/kwh në fuqi;

b) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 20-6 kV–4.32 lekë/kwh nga tarifa prej 3.9 lekësh/kwh në fuqi;

c) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 0.4 kV–6.35 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020.

2. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifave, sipas nivelit të tensionit për vitin 2020, si më poshtë:

a) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 35 kV–3.32 lekë/kwh;

b) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 20-6 kV–4.32 lekë/kwh;

c) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 0.4 kV–6.35 lekë/kwh.

3. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 4, datë 10.1.2020**

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE”
NR. 263, SERIA FK15, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s
NR. 8, DATË 2.2.2015**

Në mbështetje të nenit 16; të nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”; të nenit 5, pika 1, germa “d”; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 125/1 prot., datë 27.12.2019, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 727/3 prot., datë 16.12.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar. Në datën 27.9.2014 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42203031A.

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. është mbajtëse e licencës me nr. 263, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon në datën 2.2.2020.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, parashikohet se jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.

- Referuar sa më sipër, afati i fundit brenda të cilit shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. duhej të kishte aplikuar në ERE për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike ishte data 2.12.2019.

- Në nenin 10, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, përcaktohet: “Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje, duke plotësuar kërkesat dhe dokumentet e kërkuara në të. Në të kundërt Bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurave të shqyrtimit të aplikimit.

- Nga sa konstatuar, shoqëria “NOA Trade Energy” sh.p.k. nuk ka aplikuar brenda afatit ligjor të parashikuar për rinovimin e licencës.

- Rezulton se shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. ka kryer pagesën për aplikimin për rinovim.

- Shoqëria “NOA Trade Energy” sh.p.k. ka depozituar një dokumentacion të konsiderueshëm bashkëlidhur aplikimit të saj për rinovim të licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, por ky aplikim nuk është paraqitur në afat, sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Me vendimin nr. 215, datë 20.12.2019, të Bordit të ERE, janë miratuar disa shtesa dhe ndryshime të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të cilat kanë hyrë në fuqi pas depozitimit të aplikimit të shoqërisë “NOA Trade Energy”, ndaj në këto kushte për shqyrtimin e këtij



aplikimi është marrë për bazë legjislacioni në fuqi, në momentin e aplikimit.

- Shoqëria, përmes përfaqësuesit të saj në mbledhjen e Bordit të ERE-s, saktësoi se kërkon trajtimin si kërkesë për rinovim dhe jo si aplikim për licencim, kërkesë që nuk gjendet në përputhje me rregullimet ligjore siç citohet më lart.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 263, seria FK15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 7, datë 2.2.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe e Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 5, datë 10.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 50; të nenit 22, pika 2, germa “ç” dhe të nenit 83, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 4, pika 1, germa “ç”; të nenit 5; të nenit 8; të nenit 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; të pikës 2, germa “e” dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si dhe të nenit 15, të

“Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 125/2 prot., datë 27.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe e Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresën nr. 3051 prot., datë 12.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 810 prot., datë 12.12.2019, ka aplikuar për pajisjen me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen plotësuar nga shoqëritë tregtare”; të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit”, të ndryshuar, dhe rezulton e regjistruar si person juridik shqiptar, me vendimin e Gjykatës së Tiranës, nr. 674/1 akti, datë 5.7.1993, me numrin e identifikimit (NUIS) J61820031J.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: Import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, gazit natyror etj.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, rezulton si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c” dhe “e” (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor): plotësuar.

- Mungon pjesërisht dokumentacioni i kërkuar bazuar në germën “d” (Shoqëria ka paraqitur në ERE statutin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. (vërtetim i njësisë me origjinalin, me nr. rep. 2945, datë 10.12.2019) dhe mbetet të depozitojë në ERE aktin e themelimit dhe të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit.

- Neni 9, pika 1, germa “e”/“i” që ka të bëjë me pasqyrat financiare të audituara. Subjekti “GSA” sh.p.k. ka përcjellë në ERE pasqyrat financiare të audituara, për vitet 2017 dhe 2018, nga



të cilat rezultojn një bilanc pozitiv. Nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016.

- Neni 9, pika 1, germa “e”/“vi”, plan biznesi, i cili përfshin një analizë të kostove dhe të përfitimeve. Nuk ka paraqitur në ERE planin e biznesit.

- Neni 9, pika 1, germa “e”/“vii”. Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, ai duhet të informojë ERE-n për këtë synim dhe të japë një garanci të performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi. Aplikanti nuk ka paraqitur informacion.

- Neni 9, pika 2/“i”/“ii”/“iii”. Subjekti ka bërë përshkrimin e sasisë mesatare të gazit natyror të parashikuar për të livruar, garancinë mbi cilësinë e gazit, si dhe për të dokumentuar kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit, duke plotësuar kërkesat e kësaj dispozite.

Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe e Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 6, datë 10.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, germa “c” dhe nenit 83, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 4, pika 1, germa “c”; nenit 5; nenit 8; nenit 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “f” dhe nenin 10, pikat 1 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ERE, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 125/5 prot., datë 13.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresën nr. 3051 prot., datë 12.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 810 prot., datë 12.12.2019, ka aplikuar për pajisjen me licencë në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë).

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar në zbatim të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit”, i ndryshuar; ligjit nr. 7667, datë 28.1.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen plotësuar nga shoqëritë tregtare”, regjistruar si person juridik shqiptar, me vendimin e Gjykatës së Tiranës, nr. 674/1 akti, datë 5.7.1993 dhe mban numrin e identifikimit (NUI) J61820031J.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: import-eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, gazit natyror etj.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose



heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, rezulton si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “e” (dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor). Plotësuar.

Germa “d” plotësuar pjesërisht. Shoqëria GSA sh.p.k., ka deklaruar se do të përdorë rrjetin e transmetimit të gazit të Trans Adriatic Pipeline (TAP). Shoqëria ka paraqitur në ERE statutin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. (vërtetim i njësisë me origjinalin, me nr. rep. 2945, datë 10.12.2019) dhe mbetet të depozitojë në ERE aktin e themelimit dhe certifikatën e regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Mungon germa “e” (ii). Subjekti “GSA” sh.p.k. ka përcjellë në ERE Pasqyrat financiare të audituara, për vitet 2017 dhe 2018 nga të cilat rezulton një bilanc pozitiv. Do t’i kërkohej shoqërisë të depozitojë në ERE edhe pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016.

Mungon germa “e” (vi). Planin e Biznesit. Do t’i kërkohej shoqërisë të depozitojë në ERE Planin e Biznesit.

Mungon germa “e” (vii). Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore ai duhet të informojë ERE për këtë synim dhe të japë një garanci të performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi. Do t’i kërkohej shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Neni 9, pika 2 (i), (ii), (iii). Subjekti ka bërë përshkrimin e sasisë mesatare të gazit natyror të parashikuar për të livruar, garancinë mbi cilësinë e gazit, si dhe dokumentuar kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit, duke plotësuar kërkesat e kësaj dispozite.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 7, datë 16.1.2020

MBI MIRATIMIN E ÇMIMIT VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T’U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe VKM nr. 687, datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 5/3 prot., datë 13.1.2020, në lidhje me miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 201, datë 12.12.2019 la në fuqi vendimin nr. 8, datë 17.1.2019 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2019”, deri në miratimin e një çmimi nga ERE, mbështetur në publikimin e raportit vjetor të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX), si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit lekë/EUR.

- Në vijim të publikimit të raportit vjetor të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të Bursës Hungareze të Energjisë për vitin 2019 dhe kursit të këmbimit lekë/EUR të Bankës së Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 201, datë



12.12.2019, plotësohen kushtet për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017 "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi".

- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) është marrë çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2019, i cili rezulton në vlerën 50.36 euro/MWh.

- Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit euro/lekë për çdo muaj të vitit 2019, rezulton që kursi mesatar i këmbimit për vitin 2019 të jetë 123.01 euro/lekë.

- Nisur nga elementet e përcaktuara më sipër dhe në zbatim të formulës përlogaritëse të pikës 3, të VKM-së nr. 687, datë 22 nëntor 2017, në lidhje me metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020 është 8.0532 lekë/kWh.

- Me publikimin e raportit përfundimtar vjetor të Bankës së Shqipërisë, nëse për kursin e këmbimit lekë/EUR do të rezultojnë diferenca nga vlera e publikuar deri në marrjen e këtij vendimi, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, i cili do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike prej 8.0532 lekë/kWh, i cili do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020.

2. Me publikimin e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019, në rast se kursi i këmbimit lekë/EUR do të rezultojnë i ndryshëm nga vlera e publikuar deri në marrjen e këtij vendimi, ERE do të korrigjojë çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, i cili do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2020.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 8, datë 16.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL/FSHU SHA PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa "h", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neni 5, pika 2, e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar, neneve 15, 19, pika 1, germa "f" dhe nenit 26, të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 16.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga drejtoritë teknike nr. 5/5 prot, datë 13.1.2020, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti



dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë,

konstatoi se:

- ERE, në zbatim të nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”, ngarkohet me detyrimin për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë.

- Për sa më sipër parashikuar në VKM nr. 244/2016, të ndryshuar, draftimi i një kontrate tip që të mbulojë më së miri nga pikëpamja ligjore por edhe rregullatore interesat, të drejtat dhe detyrimet e palëve ndaj njëra tjetrës, vjen si domosdoshmëri veçanërisht në fillim të vitit ushtrimor, por që lidhet njëkohësisht edhe me bërjen efektive të ndarjes së aktivitetit të OSHEE sh.a., duke ia lënë detyrimin e garantimit të furnizimit në cilësinë e furnizuesit të shërbimit universal, shoqërisë së krijuar dhe tashmë operative që nga 1 janari 2020, FSHU sh.a.

- Në draft kontratë, janë reflektuar edhe ndryshimet e fundit të VKM-së nr. 244/2016 (VKM nr. 883, datë 27.12.2019, ku parashikohet në nenin 5, pika 2, se: “Ndërmjet furnizuesit të shërbimit universal dhe shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nënshkruhet kontrata TIP, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, e cila negociohet çdo vit, në lidhje me sasinë e energjisë së siguruar dhe çmimin për njësi, përpara fillimit të çdo viti kalendarik të ushtrimit të aktivitetit”.

- Në kuptim të sa më sipër, janë palët që kanë detyrimin për të negociuar dhe nënshkruar me njëra-tjetrën kontratë të rinovuar për çdo vit ushtrimor, në të cilën të reflektohen dispozitat apo

ndryshimet e dakordësuara që lidhen ekskluzivisht me elementet çmim dhe sasi.

- Me qëllim përmbushjen e detyrimit për sa më sipër, është draftuar kjo kontratë në frymën e kontratave të dakordësuara më herët edhe mes palëve e të konstatuara në përmbushje të parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe korrespondencat me shoqëritë e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik, pjesëmarrësit e tjerë të tregut të energjisë elektrike, Autoritetin e Konkurrencës dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Draftkontrata propozohet e strukturuar në 23 nene dhe një shtojcë të cilat adresojnë çështje që lidhen me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik nga KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., si dhe rregullimin e marrëdhënies së shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve përfshirë në këtë kontratë dhe jo vetëm programimin dhe nominimin e sasive, por edhe marrëdhënien financiare mes tyre.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 9, datë 16.1.2020**

**MBI IDENTIFIKIMIN DHE TRAJTIMIN
SI KONFIDENCIALITET TË
DOKUMENTACIONIT TË
DEPOZITUAR NGA SHOQËRIA
“WONDER” SHPK SI PJESË E
APLIKIMIT PËR TRANSFERIMIN E
KOMPETENCAVE TË MENAXHIMIT
DHE OPERIMIT TË KONCESIONIT
HEC “SASAJ”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 2 dhe nenit 3, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenit 3, nenit 4, nenit 5 dhe nenit 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; nenit 8 të “Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 30.9.2019, “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.3.2018, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.1.2020, pasi shqyrtoi relacionin nr. 5/2 prot., datë 10.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me identifikimin dhe trajtimin si konfidencial të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “Wonder” sh.p.k., si pjesë e aplikimit për transferimin e kompetencave të menaxhimit dhe operimit të koncesionit HEC “Sasaj”,

konstatoi:

- Shoqëria “Wonder” sh.p.k. me shkresën nr. 291 prot., datë 18.11.2019, protokolluar në ERE me nr. 724/3 prot., datë 20.11.2019, ka kërkuar trajtimin me konfidencialitet të dokumentacionit të aplikimit që kjo shoqëri ka bërë në ERE për transferimin e kompetencave të menaxhimit dhe operimit të koncesionit HEC “Sasaj”;

- Shoqëria “Wonder” sh.p.k., shprehet se dokumentacioni i paraqitur në dosje është produkt ekstremisht konfidencial i shoqërive “Wonder” dhe “Hydropower-SAS” dhe jep autorizimin për t’i vënë në dispozicion shoqërisë “Energo-SAS” sh.p.k., vetëm dokumentet si më poshtë:

- Certifikatë regjistrimi i personit të tatueshëm “Hydropower SAS” sh.p.k.;

- Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar të QKB-së për subjektin “Hydropower SAS” sh.p.k.;

- VKM nr. 634, datë 18.9.2003;

- VKM nr. 501, datë 23.7.2004;

- Marrëveshje koncesionare e botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 18 gusht 2004;

- ERE, më datë 23.12.2019, zhvilloi një seancë dëgjimore, me qëllim argumentimin e kërkesës për trajtimin me konfidencialitet për secilin prej dokumenteve që ka depozituar shoqëria “Wonder” sh.p.k., në aplikimin për transferimin e kompetencave të menaxhimit dhe operimit të koncesionit HEC “Sasaj”, aq sa përhapja e tij të cenojë integritetin, strategjinë, politikat e shoqërisë etj.;

- Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, në nenin 2, pika 2, ka si parim bazë aksesin e plotë në informacionin që quhet publik;

- Gjithashtu, në mbështetje dhe të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014, duhet pasur parasysh se zbatimi i së drejtës për informim ka përjashtimet dhe kufizimet e veta. Gjithsesi ligji parashikon se çdo kufizim duhet të jetë i domosdoshëm, proporcional dhe mund të bëhet vetëm në rastet kur: aksesin apo dhënia e informacionit mund të kufizohet dhe nga mbrojtja e të dhënave personale apo konfidenciale, si dhe sekreti tregtar;

- Ligji për të drejtën e informimit nuk jep përkufizimin e të dhënave personale, por referon në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ku në nenin 3 përcaktohet ky përkufizim: “Të dhëna personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social”;

- Mbrojtja e këtyre të dhënave personale të një personi fizik është një e drejtë, sa kohë mungon një interes publik për t’i publikuar ato, ose kur publikimi i tyre i sjell një dëm shumë të madh individit. Në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, të dhënat personale përpunohen vetëm:

a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;

- Përveç dokumentacionit që lidhet me persona fizikë, duke qenë se në dosjen e aplikimit të shoqërisë Wonder sh.p.k. gjenden dhe dokumente



që i përkasin personave juridikë, shpjegojmë në vijim në lidhje me kufizimet që ka përhapja e sekretit tregtar, konkretisht te neni 18, i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar:

1. Sekreti tregtar është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument, që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili, nëse do t’u përhapej personave të paautorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë.

2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkëlqen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

- Në dosjen e depozituar për aplikim për transferim licence, shoqëria “Wonder” sh.p.k., nuk ka përcaktuar se, ndonjë e dhënë apo dokument i depozituar në ERE është sekret tregtar apo informacion i brendshëm i shoqërisë dhe si i tillë nuk duhet të përhapet, në mënyrë që ky informacion të trajtohej si i tillë që në fazën e shqyrtimit të aplikimit të kësaj shoqërie. Tashmë, ky informacion është shqyrtuar dhe procedura është ezauruar me vendimmarrjen e ERE-s. Aktualisht, edhe sa vlerësohet, nuk jemi në rrethanat e klasifikimit të dokumentacionit të depozituar nga “Wonder” sh.p.k., si sekret tregtar.

- Dokumentacioni që nuk vlerësohet si konfidencial, është i natyrës publike, i aksesueshëm për publikun dhe si i tillë nuk trajtohet me konfidencialitet.

- Në zbatim të kufizimeve për mbrojtjen e të dhënave personale/konfidenciale dhe në mungesë të dhënies së pëlqimit nga subjekti i këtyre të dhënave, një pjesë e dokumentacionit nuk mund të përhapet te të tretët.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Identifikimin dhe trajtimin si konfidencial të dokumentacionit si më poshtë:

- Prokura e posaçme (autorizim) i shoqërisë “Wonder” sh.p.k., nr. 269 prot., datë 22.8.2019;

- Kontratë e lidhur ndërmjet “Wonder” sh.a dhe “Hydropower SAS” sh.p.k.;

- Vërtetim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, datë 21.8.2019, për administratorin;

- Vërtetim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, datë 21.8.2019, për “Hydropower SAS” sh.p.k.;

- Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, datë 21.8.2019, për administratorin;

- Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, datë 21.8.2019, për “Hydropower SAS” sh.p.k.;

- Fotokopje e kartës së identitetit për administratorin;

- Lista e punonjësve të HEC SASAJ dhe organigrama e “Hydropower SAS” sh.p.k.;

- Pasqyra financiare të ndërmjetme për shoqërinë “Hydropower Sas”, viti 2019;

- Nxjerrje llogarie për “Hydropower SAS” sh.p.k., lëshuar nga Raiffeisen Bank, datë 18.4.2019.

2. Ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore, për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi dhe trajtimin me konfidencialitet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të të gjitha dokumenteve të vlerësuar si të tilla në këtë vendim.

3. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesuara lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
PETRIT AHMETI

**VENDIM****Nr. 10, datë 20.1.2020**

**MBI KËRKESËN PËR MOS
LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC”
SHPK NGA ERE DHE KËRKESËN PËR
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-s
NR. 187, DATË 25.11.2019, PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 67 dhe nenit 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 16, pika 1, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 14/1 prot., datë 16.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, vendosi të licencojë me kusht shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 Kw, për një afat 24 vjet e 2 muaj.

- Deri në plotësimin e kushteve të parashikuara në këtë vendim, shoqëria nuk mund të operojë e për rrjedhojë të sjellë efekte për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

- Në vijim të këtij licencimi në ERE ka mbërritur shkresa e z. Petrit Kutolli, protokolluar në ERE me nr. 782/1, datë 12.12.2019, me anë të së cilës ky i fundit ka paraqitur kërkesë për mos licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k. nga ERE, duke kërkuar pengimin e këtij licencimi deri sa proceset gjyqësore civile apo penale të ngritura kryesisht apo në të cilat janë palë ankuesi dhe administratorja e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., të zgjidhen gjyqësisht.

- Kërkesa sipërcituar ka ardhur pas përfundimit të afateve për pritjen e komenteve e objeksioneve siç është parashikuar në nenin 10, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si dhe pas marrjes së vendimit për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k. me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, të Bordit të ERE-s.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 782/3, datë 19.12.2019, z. Petrit Kutrolli, në cilësinë e palës së interesuar, ka ndryshuar objektin e kërkesës së tij, sipërcituar, dhe ka kërkuar rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”.

- Në bazë të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Konstatohet se kërkesa për rishikim të vendimit të ERE-s është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të nenit 16, pika 2, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi do të shqyrtojë provën e re dhe do të nxjerrë vendimin e tij brenda 30 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës për rishikim.

- Ankuesi pretendon, ndër të tjera, se znj. A. Xh., administratore e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., ka paraqitur dokumente të rreme dhe të falsifikuara për aplikimin për licencim në ERE.

- Në mbështetje të pretendimeve për paraqitjen e dokumenteve të rreme, ato lidhen drejtpërdrejtë me procesin e licencimit të

subjektit, janë vërtetimet e gjykatave për statusin në proces të procedimeve penale në të cilat palë e paditur rezulton administratorja e shoqërisë së licencuar.



- Sa më sipër, përbën një rrethanë të re, të ndryshme nga ato për të cilat ERE është shprehur me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”.

- Në zbatim të nenit 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

- Për shkak të kompleksitetit të çështjes në shqyrtim, nevojës për verifikime që lidhen me vërtetimin se shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata), janë rrethana që kërkojnë zgjatjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së ankuesit, me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar të mbështetur në prova, të verifikuara dhe të konfirmuara nga organet kompetente.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të shtyjë shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, “Për licencimin e shoqërisë ‘MP-HEC’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Niçë’”, me 30 (tridhjetë) ditë, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi

2. Të sigurohen vërtetimet e nevojshme nga organet shtetërore, si dhe gjyqësore me qëllim shqyrtimin në afat të kërkesës për rishikim të vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë